



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

Zyra Ligjore - Zakonodavna Kancelarija - Legal Office

Raporti për Thjeshtësimin dhe Harmonizimin e Lejeve dhe Licencave në Autoritetin Rregullativ Shërbimeve të Ujit¹

¹ Kjo analizë juridike është miratuar në Mbledhjen e 254-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 04/254 të datës 26.03.2025.

LICENCË PËR SHËRBIME TË UJËSJELLËSIT

1. Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Ligji Nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (këtu më tutje ligji) është Ligji në bazë të të cilit bazohet licenca e Autoritetit Rregullativ të Shërbimeve të Ujit (më tutje autoriteti). Ligji Nr. 05/L -042 në nenin 1.11 përcakton: “Licencë e shërbimit - leje e lëshuar nga Autoriteti me të cilën jepet autorizimi për ofrimin e shërbimit të ujit”. Pra qysh në definicionin e ligjit përcaktohet kuptimi i licencës për shërbime të ujësjellësit. Ndërkaq bazuar në nenin 4 të Ligjit Nr. 05/L -042 Autoriteti rregullativ është kompetent për licencimin e ofruesve të shërbimeve.

Ligji Nr. 05/L -042 në nenin 15 përcakton licencën për shërbime. Paragrafi 1 i nenit 15 lidhur me këtë licencë përcakton: “Asnjë ofrues i shërbimeve nuk mund të ofrojë shërbime në Republikën e Kosovës pa pasur licencë përkatëse për shërbime”. Pra Licenca e ofruesit të shërbimeve bazën juridike e ka në nenin 15 të Ligjit Nr. 05/L -042. Ndërkaq procedura e licencimit përcaktohet sipas aktit nënligjor dhe rregullores që nxjerr autoriteti. Baza ligjore e licencës së vetme që e lëshon ky autoritet është neni 15 i Ligjit Nr. 05/L -042.

1.2 Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Kjo licencë ka për qëllim në veprimtarinë e saj të bëjë rregullimin e ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura, shërbimet e ujit me shumicë të papërpunuar, shërbime e ujit me shumicë të përpunuar; në Sektorin publik.

1.3 Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Sipas nenit 17.1 të Ligjit Licencat për shërbim lëshohet për periudhën jo më të shkurt se një (1) vit dhe jo më gjatë se dhjetë (10) vjet.

1.4. Taksa e nevojshme për pagesë:

Pagese per aplikim - 1200 euro 2. Pagesa e taksës vjetore për licencim;

1.5 Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Certifikata e regjistrimit të aplikuesit si organizatë biznesore, e lëshuar nga agjencia e autorizuar për regjistrimin e organizatave biznesore; [Original]
- Dokumenti i regjistrimit në organet tatimore; [Original]
- Dëshmia e fundit në lidhje me kushtet higjieno – sanitare, lëshuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë/Inspektorati Sanitar i Kosovës [Kopje]
- Letër rekomanduese nga Instituti Kombëtar për shëndetësi publike për (mos) lejimin e ujit për konsum njerëzor, të funizuar nga ofruesi i shërbimeve; [Kopje]
- Leja e mjedisit për shfrytëzimin e burimeve të ujit; [Original]
- Leja e mjedisit për shkarkimin e ujërave të ndotura; [Original]
- Marrëveshja për shërbime e nënshkruar (apo në procedim e sipër) nga komunat përkatëse dhe ofruesi i shërbimeve; [Kopje]

- CV e drejtuesit ose menaxherit teknik [Kopje]
- Dokumenti i kualifikimit të drejtuesit ose menaxherit teknik; [Kopje]
- Dëshmia e penalitetit për drejtuesin [Origjinal]
- Pasqyrat financiare vjetore, të auditura, për dy (2) vitet e fundit; [Kopje]
- Plani i biznesit (3 vjeçar); [Kopje]
- Hartat (skemat) e informacioneve gjeografike që përfshijnë: (i) zonën e shërbimit (përfshirë ndaras pjesët urbane dhe rurale), (ii) objektet e trajtimit (dhe rezervimit) të ujit/ujërave të ndotura; (iii) burimet e ujit të shfrytëzuar; si dhe (iv) rrjeti kryesor dhe shpërndarës; [Kopje]
- Autorizimi nga organi më i lartë i udhëheqjes (Bordi i Drejtorëve) për personin, të cilit i është dhënë e drejta për të kryer të gjitha veprimtaritë për aplikim të marrjes së licencës; [Kopje]
- Autorizimi i bordit të drejtorëve [Kopje]

2.Rekomandime:

1. Të krijohet një Pikë e vetme e kontaktit;
2. Me rastin e dhënies së licencës të shfrytëzohet parimi i ndihmës administrative dhe veprimit ex officio të organit, sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative;
3. Të reduktohen disa dokumente për këtë licencë.

3.Arsyetingimi i rekomandimeve:

1. Të krijohet një Pikë e vetme e kontaktit;

Duke u bazuar në kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për të lehtësuar çështjen e dhënies së licencës, duhet të krijohet në autoritet një pikë e vetme e kontaktit. Kjo pikë e vetme e kontaktit do të ndihmojë të gjithë aplikuesit në procesin e aplikimit dhe shqyrtimit të licencave.

2. Me rastin e dhënies së licencës të shfrytëzohet parimi i ndihmës administrative dhe veprimit ex officio të organit, sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative;

Autoriteti, si dhënësi i licencës në këtë rast, duhet që veprime të caktuara për të lëshuar lejen dhe licencën, ti kryejë sipas parimit të veprimit sipas detyrës zyrtare.

3. Të reduktohen disa dokumente për këtë licencë.

Disa dokumente, siç është CV e drejtuesit ose menaxherit teknik duhet të vërtetohen përmes deklaratës nën betim. Në anën tjetër Certifikata e regjistrimit të aplikuesit si organizatë biznesore, e lëshuar nga agjencia e autorizuar për regjistrimin e organizatave biznesore dhe Dokumenti i regjistrimit në organet tatimore duhet të vërtetohen sipas parimit ex officio.